

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6300
E hënë, 26 prill 2021
çmimi 0.40

53-vjetori i lindjes së ish-presidentit Hashim Thaçi. Urimi i kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama

EDHE 100!



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SHQIPËRIA KA MBAJTUR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME PARLAMENTARE

PS-ja, FITUESE E ZGJEDHJEVE NË SHQIPËRI



LSAPHOTO.COM

Shqipëria ka organizuar të dielën zgjedhjet e përgjithshme parlamentare. Procesi zgjedhor është mbajtur sipas standardeve demokratike dhe pa ndonjë incident që do të mund ta dëmtonte kredibilitetin e zgjedhjeve. Incidentet që janë evidentuar kanë

pasur të bëjnë me identifikimin biometrik dhe disa raste të fotografimit të votës. Pjesëmarrja në zgjedhje ishte 48.59 për qind. Menjëherë pas mbylljes së votimeve janë publikuar Exit-Pollet e para, ku Partinë Socialiste e kanë nxjerr fituese të zgjedhjeve me 46.9 për

qind (71 mandate), Partinë Demokratike me 43.9 për qind (63 mandate) dhe Lëvizjen Socialiste për Integrim me 6.9 për qind të votave (6 mandate). Autoritetet zgjedhore në Shqipëri kanë bërë me dije se rezultati i zgjedhjeve do të bëhet publik pas dy ditësh

OPINION

GRUPI MARKSIST LENINIST I KOSOVËS DHE DEMONSTRATAT E VITIT 1981

F. 8

Shkruan:
Ismail Sylta



AKTUALE




BYTYÇI JEP DORËHEQJE NGA POZITA E ZËDHËNËSIT TË PDK-së, I BASHKOHET EKIPI TË VESELIT

F. 3

KËRKOHEM KOMPENSIM PËR MËSIMIN PLOTËSUES

F. 6

EKONOMI



GJERMANIA DHE ITALIA, VENDET KYESORE TË TREGTIMIT ME KOSOVËN

F. 8

GASTRONOMËT KËRKOJNË SUBVENCIONIM NË BAZË TË PERFORMANCËS

F. 9

AAK-ja FTON NË INTERPELANCË MINISTRIN MURATI, SHKAK ULJA E SHITESAVE PËR PENSIONISTËT

F. 9

OPOZITA I BËN THIRRJE KURTIT TË REFLEKTOJË KARSHI DIALOGUT ME SERBINË

FAQE 3



SHËNOHET RËNIE E RASTEVE TË REJA ME COVID NË KOSOVË

FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjermania, e mbyllur deri në këtë muaj?

Berlin, 25 prill - Derisa Gjermania po vazhdon të regjistrojë mijëra raste të infektuarve me koronavirus, hapja nuk pritet të ndodhë së shpejti. Ky shtet është duke planifikuar të mos hapet as në fillim të muajit të ardhshëm për shkak të gjendjes me pandeminë. Hapja pritet të ndodhë në fund të muajit maj ose në

muajin qershor. Ministri i Financave, Olaf Scholz, ka thënë për gazetën gjermane "Bild am Sonntag", se shtetit i nevojitet një planifikim se si t'i kthehet jetës normale dhe se ky plan duhet të revokohet pas pak ditësh. Ai ka thënë se qeveria duhet t'i tregojë hapat për hapjen e vendit deri në fillim të verës. "Kemi nevojë për një plan se si t'i

kthehemi jetës normale, por ky nuk duhet të jetë një plan i cili duhet të revokohet pas vetëm pak ditësh", ka thënë Scholz.

Gjermania radhitet e 10-ta në botë për nga numri më i madh i të infektuarve, me gjithsej 3 milionë e 286 mijë e 187 raste. Deri tani në këtë shtet kanë vdekur mbi 82 mijë persona.



VMRO-ja kërkon lirimin e të dënuarve për dhunën në Kuvend

SHKUP, 25 PRILL - Opozita ka protestuar të dielën para Qeverisë dhe Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, me kërkesën për lirimin e të dënuarve për dhunën në Kuvend më 27 prill të vitit 2017.

Para katër vjetësh, një protestë e opozitës ishte përshkallëzuar në dhunë, pasi demonstruesit kishin hyrë në Kuvend, duke sulmuar fizikisht shumë deputetë, në mesin e të cilëve edhe liderin e atëhershëm të opozitës, Zoran Zaev, tani kryeministër dhe kryetarin e opozitës shqiptare, Ziadin Sela.

Protesta ishte organizuar kundër zgjedhjes së një shqiptari për kryetar të kuvendit, por edhe si refuzim për ndërrimin e pushtetit që deri atëherë drejtohej nga



VMRO-DPMNE-ja, që udhëhiqej nga Nikolla Gruevski. Për dhunën në Kuvend, 16 persona, kryesisht zyrtarë të opozitës, janë dënuar me mbi 180 vjet burg, nën akuzën për "terrorizëm dhe prishje të

rendit kushtetues". Lideri i partisë maqedonase në opozitë, VMRO-DPMNE, Hristijan Mickovski, ka thënë para protestuesve se të dënuarit janë "njerëz të ndershëm, që kishin protestuar për mbrojtjen e

rendit kushtetues". "Ne nuk duhet të heshtim për padrejtësinë. Burgu i drejtësisë është më i vështiri dhe shoqëria nuk duhet të lejojë improvizime. Pushteti po mban në burg ata që mbrojtën shtetin, ndërsa po lë të lirë

kriminelët dhe bosët e drogës", ka deklaruar Mickovski.

Ndërkohë, vazhdojnë edhe procese gjyqësore kundër drejtuesve të tjerë të VMRO-DPMNE-së, përfshirë edhe ish-kryeministrin Nikolla Gruevski dhe ish-kryetarin e Kuvendit, Trajko Veljanovski. Protesta është mbështetur edhe nga ish-kryeministri Nikolla Gruevski i cili ndodhet në arrati në Hungari, ku ka fituar azilin politik.

Gruevski është dënuar me dy vjet e gjysmë burg për shpërdorim të detyrës për blerjen e një makine zyrtare në vlerë prej gjysmë milioni euro, por ndaj tij po zhvillohen edhe disa procese të tjera gjyqësore. Hungaria ka refuzuar ekstradimin e tij, duke e pajisur Gruevskin edhe me shtetësi hungareze.

Jep dorëheqje kryeministri i Armenisë

YEREVAN, 25 PRILL - Kryeministri i Armenisë, Nikol Pashinian, ka paraqitur dorëheqjen e tij, duke i hapur rrugë mbajtjes së zgjedhjeve të reja parlamentare, pas një krize politike që është shkaktuar si pasojë e luftës me Azerbajxhanin që ishte zhvilluar vitin e kaluar. "Sipas marrëveshjes me presidentin dhe forcat politike, sot kam dhënë dorëheqje në mënyrë që zgjedhjet e reja parlamentare të mbahen më 20 qershor", ka shkruar Pashinian në llogarinë e vet në "Facebook". Pashiniani ka thënë se deri në

mbajtjen e zgjedhjeve ai do t'i kryejë detyrat e tij si kryeministër në detyrë, duke shtuar se planifikon që të garojë në zgjedhje. "Do të jem kandidat për kryeministër. Nëse njerëzit vendosin që unë duhet të jap dorëheqje si kryeministër, unë do ta respektoj vullnetin e tyre dhe nëse ata duan që unë ta vazhdoj punën time si kryeministër, gjithashtu do ta respektoj vullnetin e popullit", ka shkruar ai.

Ky vendim vjen pas disa ndryshimeve që Armenia ka bërë në Kodin Zgjedhor,

ndryshime të cilat, sipas opozitës, janë bërë që ta ndihmojnë Pashinianin që të fitojë në zgjedhje. Armenia është në krizë politike që prej se Pashinian nënshkroi marrëveshjen e armëpushimit në nëntorin e kaluar, duke i dhënë fund luftës me Azerbajxhanin për rajonin e Nagorno-Karabakut. Kjo marrëveshje u ndërmjetësua nga Rusia.

Pas bisedimeve me opozitën në muajin mars, Pashinian ishte pajtuar që zgjedhjet e reja të mbahen në qershor. Sipas



sondazheve, mbështetja për qeverinë e Pashinianit ka rënë në 30 për qind nga 60 sa ishte më parë.

Zjarr në një spital në Bagdad, humbin jetën 82 persona, plagosen 110 të tjerë

BAGDAD, 25 PRILL - Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në Bagdad, ku 82 persona kanë humbur jetën si pasojë e një zjarri që ka përfshirë spitalin ku po trajtoheshin pacientët me Covid-19.

Autoritetet atje kanë bërë me dije se si pasojë e zjarrit kanë mbetur të plagosur edhe 110 persona të tjerë. Ngjarja ka ndodhur në spitalin Ibn al-Khatib në Bagdad, ndërkohë në

vendngjarje kanë mbërritur zjarrfikësit dhe forca të shumta policore. "Ekipet e mbrojtjes civile janë ende në vendin e aksidentit, duke hetuar shkaqet që çuan në këtë zjarr, i cili shkaktoi

humbjen e jetës së shumë pacientëve dhe shoqëruesve të tyre", është thënë në një deklaratë të lëshuar për opinionin publik nga Ministria e Shëndetësisë e Irakut.



Opozita i bën thirrje Kurtit të reflektojë karshi dialogut me Serbinë

Përfaqësuesit e partive opozitare kanë kërkuar nga kryeministri Albin Kurti që të reflektojë në raport me dialogun me Serbinë. Po ashtu, ata kanë kërkuar që në këtë proces të jetë e përfshirë edhe ShBA-ja. Deputetja e PDK-së, Blerta Deliu-Kodra, ka thënë se dialogu duhet të jetë një prej pikave kryesore të qeverisë. Ndërsa deputeti i AAK-së, Pal Lekaj, ka thënë se Kosova nuk duhet ta nisë dialogun pa një plan konkret. Ai ka thënë se të gjitha marrëveshjet ku nuk ka qenë ndërmjetësuere ShBA-ja nuk janë implementuar



PRISHTINË, 25 PRILL - Opozita në Kosovë ka kërkuar nga qeveria Kurti që të reflektojë në raport me dialogun me Serbinë. Përfaqësuesit e këtyre partive kanë vlerësuar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) duhet të jenë patjetër pjesë e këtij procesi.

Deputetja e Partisë Demokratike e Kosovës (PDK), Blerta Deliu-Kodra, ka thënë se dialogu duhet të jetë një prej pikave kyçe të qeverisë. Në këtë kontekst, ajo ka thënë se qeveria Kurti duhet të tregohet e vëmendshme karshi kërkesave të qytetarëve sepse dialogu është një prej temave më me peshë për Kosovën. "Absolutisht duhet të jetë një prej pikave e cila do të diskutohet në vazhdimësi. Unë e kuptoj që gjendja e rënduar

me pandeminë nuk do të mund ta lërë të papërfshirë qeverinë edhe në raport me obligimet e tjera që ka, por kjo qeveri duhet të tregohet e vëmendshme karshi kërkesave të qytetarëve të Kosovës e natyrisht një prej kërkesave dhe shqetësimeve që i ka do të jetë edhe çështja e dialogut sepse është një prej çështjeve që është diskutuar shumë dhe ne presim reflektim të zotëri Kurtit në raport në njërin prej temave të rënda, por gjithsesi me peshë për Kosovën", ka thënë Deliu-Kodra për "EO". Ndërsa deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, ka thënë se Kosova nuk duhet ta nisë dialogun pa një plan konkret, dhe se të gjitha marrëveshjet ku nuk ka qenë ndërmjetësuere ShBA-ja

nuk janë implementuar. "Sa i përket dialogut, ne e kemi bërë të qartë që nuk guxojmë të rrëshqasim në dialogun që më së pari nuk e dimë për çfarë do të dialogojmë. Ne jemi opozitë dhe do të jemi monitorues të dialogut, por ende nuk kemi marrë vendim që të jemi pjesë e dialogut. Në tavolinën që është ShBA-ja i besoj dialogut, por unë vlerësoj edhe qëndrimin e BE-së. Nëse nisemi nga e kaluara ne nuk kemi pasur ndonjë zgjidhje të përhershme dhe të gjitha marrëveshjet ku nuk ka qenë ndërmjetësuere ShBA-ja nuk janë implementuar", ka thënë

Lekaj. Më tutje, ai ka thënë se do të jenë monitorues 24 orë të qeverisë nëse nuk punon në interes të shtetit dhe qytetarëve dhe se AAK-ja do të punojë në favor të forcimit të shtetit dhe qytetarëve të Kosovës. Sipas tij, pozita nuk ka dialoguar me opozitën sepse po dominon arroganca e numrave e deputetëve të pozitës. "Sa i përket asaj që është në të mirë të Kosovës, ne do të jemi pozitivë dhe do të vlerësojmë pozitivisht çdo veprim që shkon në favor të mirë të qytetarëve dhe forcimit të shtetit të Kosovës. Po e

përsëris, ne do të jemi monitorues 24 orë të qeverisë nëse nuk punon në interesin e shtetit dhe qytetarëve. Nuk ka dialog me opozitën dhe po dominon arroganca e numrave të deputetëve që kanë, por shpeshherë numri i deputetëve nuk ka treguar apo arroganca e qeverisë nuk ka qenë pozitive në asnjë rast dhe mendoj që ne si AAK do të bëjmë opozitë në favor të forcimit të shtetit dhe qytetarëve të Kosovës. Qeveria e ka obligim dhe përgjegjësi ta drejtojë vendin për të mirën e shtetit dhe qytetarëve", është shprehur Lekaj.

Bytyçi jep dorëheqje nga pozita e zëdhënësit të PDK-së, i bashkohet ekipit të Veselit



PRISHTINË, 25 PRILL (ER) - Avni Bytyçi ka bërë me dije se ka dhënë dorëheqje nga pozita e zëdhënësit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Bytyçi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se tani e tuje do të punojë me ekipin mbrojtës të Kadri Veselit, i cili gjendet në paraburgim në Hagë. "Para disa ditësh, pas një diskutimi të gjatë me kryetarin në detyrë, z. Hoxhaj, kam kërkuar nga ai që të më lirojë nga detyra e zëdhënësit të partisë në fund të këtij muaji. Jam mirënjohës për mundësinë që më është dhënë, të qenit zëdhënës i një partie kaq të madhe, me traditë e shumë vlera. Është një privilegj që shumë pak e kanë pasur fatin ta kenë. Jam thëllësisht falënderues për hapësirën që më është dhënë në PDK. Përkrahja nuk më ka munguar

asnjëherë, në asnjë nivel. Përkundrazi, unë gjithmonë jam gjendur në një mes të njerëzve të cilët më kanë motivuar për të ecur përpara. Mirëpo, rrugëtimi im në politikë është shkurtuar pa dëshirë nga rrethanat në të cilën gjenden themeluesit e shtetit të Kosovës dhe ish-kryetari i partisë, z. Veseli. Gjatë muajve në vijim unë do të punoj ngushtë me ekipin mbrojtës të z. Veseli në Hagë. Për ta ruajtur parimin e mosndërhyrjes, paanshmërinë dhe për të siguruar që puna ime nuk konsiderohet ndërhyrje politike në asnjë formë, e pas një bisede të shkurtër me z. Veseli, po tërhiqem nga çdo funksion dhe pozitë që kam në Partinë Demokratike të Kosovës", ka shkruar Bytyçi. Me këtë rast, ai ka falënderuar mediat dhe strukturat e PDK-së për bashkëpunimin. "Shfrytëzoj

rastin t'i falënderoj të gjithë. Më vjen sinqerisht keq që po largohem në këto rrethana në të cilat gjendet partia, megjithatë nuk mund të mohoj se për mua personalisht, edhe po besoj për shumë të tjerë, beteja ligjore për pafajësinë e themeluesve të UÇK-së në Hagë, është beteje më e rëndësishme sesa karriera ime personale, besa edhe vetë fati im në politikë. Rruga e jetës është shumë interesante. Ka qenë rastësi takimi im i parë me Kadri Veselin, por jo edhe rrugëtimi im në politikë përkrah tij. Po ajo që më bën krenar, është që u kam qëndruar besnik parimeve të ndershmërisë, mosmashtimit dhe përkushtimit për përgjegjësitë, detyrat dhe zotimet e mia. Në anën tjetër më vjen keq që ndoshta nuk kam ditur të punoj më mirë e të bëj më shumë", ka shkruar Bytyçi.

Shqipëria ka mbajtur zgjedhjet e përgjithshme parlamentare

PS-ja, fituese e zgjedhjeve në Shqipëri

Shqipëria ka organizuar të dielën zgjedhjet e përgjithshme parlamentare. Procesi zgjedhor është mbajtur sipas standardeve demokratike dhe pa ndonjë incident që do të mund ta dëmtonte kredibilitetin e zgjedhjeve. Incidentet që janë evidentuar kanë pasur të bëjnë me identifikimin biometrik dhe disa raste të fotografimit të votës. Pjesëmarrja në zgjedhje ishte 48.59 për qind. Menjëherë pas mbylljes së votimeve janë publikuar Exit-Pollet e para, ku Partinë Socialiste e kanë nxjerr fituese të zgjedhjeve me 46.9 për qind (71 mandate), Partinë Demokratike me 43.9 për qind (63 mandate) dhe Lëvizjen Socialiste për Integrim me 6.9 për qind të votave (6 mandate). Autoritetet zgjedhore në Shqipëri kanë bërë me dije se rezultati i zgjedhjeve do të bëhet publik pas dy ditësh



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

Prishtinë, 25 prill - Shqipëria të dielën ka mbajtur zgjedhjet e përgjithshme parlamentare. Procesi zgjedhor, i cili është hapur në orën 7:00 dhe është mbyllur në orën 19:00, në

Pjesëmarrja në zgjedhje ishte 48.59 për qind. Menjëherë pas mbylljes së votimeve janë publikuar Exit-Pollet e para, ku Partinë Socialiste e kanë nxjerr fituese të zgjedhjeve me 46.9 për qind (71 mandate), Partinë Demokratike me 43.9 për qind (63 mandate) dhe Lëvizjen

Shqipërisë, Ilir Meta, pas votimit ka ftuar qytetarët shqiptarë që t'i votojnë më të ndershmit. "Të zgjedhin kandidatët më të mirë dhe më të ndershëm. Presidenti ka një agjendë e cila mbivendoset çdo sekondë, por punën më të rëndësishme sapo e kreu. E sotmja është një akt patriotik, çdo gjë mbrohet me votë. Do ta bindim Evropën se jemi një popull që e meriton integrimin. Mbrojtja e atdheut, detyrë mbi detyrat. Përpara drejt kutive, votoni të ndershmit, jo ata që do t'iu binden si kukulla", ka deklaruar presidenti Meta. Ndërsa kryeministri dhe lideri i Partisë Socialiste (PS), Edi Rama, ka thënë se demokracia është sport ku të gjithë qytetarët duhet të zbrisin në fushë për t'i gjuajtur penalltitë. "Sot është një ditë shumë e bukur. Sot është dita të mos ushqejmë asnjë ndjenjë negative ndaj askujt që

"Një ditë e mrekullueshme për vendin tonë. Është dita kur të gjithë ne kemi fuqinë në dorën tonë për fëmijët tuaj, për familjen, për vendin, për kombin. Sot është dita të dilni dhe të votoni masivisht, të bëni të mundur të ardhmen që dëshironi për familjen, vendin dhe familjen tuaj. Sot është dita e Shqipërisë, e demokracisë. Jam i lumtur që votën time e kam hedhur sot në lagjen ku kam lindur dhe jam rritur. Zoti e bekoftë Shqipërinë!", ka thënë Basha.

Për zgjedhje të qeta ka bërë thirrje edhe kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI), Monika Kryemadhi. "Dua t'u bëj thirrje të gjithë qytetarëve që t'u drejtohen qendrave të votimit të qetë, të bindur për atë që duan ta realizojnë nëpërmjet votës së tyre. Vota e qytetarëve është një votë e shenjtë, është një votë që për hir të së vërtetës do t'u japë

edhe shumë politikanë të Kosovës. Në mesin e tyre ka qenë edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Pas votimit, ai ka bërë thirrje që të votohet për të gjitha ata që kanë pasaportë shqiptare. "Sot është dita e demokracisë. Ftoj të gjithë qytetarët të respektojnë atdheun, duke votuar dhe duke bërë zgjedhjen më të mirë sipas parimeve dhe vlerave që secili ka. Dita është e bukur, e diel me diell, moti është i mirë, kështu do të jetë deri në mbrëmje. Ju uroj ditë të bukura edhe mbarësi për Shqipërinë dhe secilin njeri që ashtu sikurse unë e ka pasaportën e Shqipërisë. Ju uroj suksese", ka thënë Kurti.

Por një veprim i tillë i Kurtit është kundërshtuar nga opozita në Kosovë dhe shoqëria civile. Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka thënë se Kurtit më shumë i interesojnë bashkëpartiakët në Shqipëri se fati i qytetarëve të Kosovës, të cilët janë duke u ballafaquar me pandeminë dhe mungesën e vaksinave anti-Covid. "Albin Kurti për të satën herë po shfaqet në Shqipëri si kryeministri i Kosovës që më shumë i interesojnë bashkëpartiakët atje se fati i bashkëqytetarëve këtu. Ndërkohë Shqipëria ka arritur numrin e 400 mijë qytetarëve të vaksinuar, në Kosovë janë vetëm 20 mijë të tillë në pritje të një tjetër kontingjenti ndihmash me vakcina. Në takimim me drejtorin e përgjithshëm të Spitalit të Prizrenit, dr. Afrim Avdaj, mësova se në këtë qytet të madh nuk ka asnjë vaksinë të vetme në dispozicion, ndërkohë që kërkesat e qytetarëve janë të larta. Edhe qendrat e tjera të vaksinimit në Kosovë janë të mbyllura. Njerëzit po infektohen edhe më shumë, të tjerët po vdesin në mungesë të vaksinave e kryeministri Kurti me ministrat e tij po bëjnë xhiro me xhupa e



përgjithësi është zhvilluar në një atmosferë të qetë dhe pa ndonjë incident. Incidentet e vogla që janë evidentuar kanë qenë probleme me identifikimin biometrik dhe disa raste të fotografimit të votës me të cilat është marrë drejtësia. Në këto zgjedhje është vërejtur pjesëmarrje më e lartë e qytetarëve në krahasim me zgjedhjet e kaluara.

Socialiste për Integrim me 6.9 për qind të votave (6 mandate). Autoritetet zgjedhore në Shqipëri kanë bërë me dije se rezultati i zgjedhjeve do të bëhet publik pas dy ditësh. Krerët shtetërorë dhe politikë qysh në fillim të procesit u kanë bërë thirrje qytetarëve që ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votimit. Presidenti i Republikës së




me votën e vet shpreh një opinion tjetër. Të mos harrojmë se jemi një familje e madhe në të njëjtin atdhe. Askush të mos harrojë se demokracia është një sport pa spektatorë dhe të gjithë duhet të zbrisin në fushë. Ndaj zbrisni në fushë dhe gjuani penalltinë tuaj", ka thënë Rama pas votimit.

Në anën tjetër, kryetari i Partisë Demokratike (PD), Lulzim Basha, ka thënë se dita e zgjedhjeve është dita e Shqipërisë dhe demokracisë.

mundësinë dhe shansin të rinjve dhe të rejave, të gjithë qytetarëve, që nëpërmjet verdiktit të tyre ta çojmë Shqipërinë më shumë se kurrë drejt Evropës", ka deklaruar Kryemadhi.

Shumë politikanë të Kosovës votojnë në Shqipëri

Në zgjedhjet parlamentare të Shqipërisë të dielën kanë votuar



deklarata për mot të mirë në Shqipëri”, ka shkruar Hoxhaj në profilin e vet në “Facebook”.

Ndërsa ish-ministri i Shëndetësisë dhe deputeti i LDK-së, Armend Zemaj, ka vlerësuar se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, nuk është duke treguar asnjë përgjegjësi në raport me situatën pandemike në vend. Në profilin e vet në “Facebook”, Zemaj ka shkruar se “kryeministri në Kosovë po e mban kokën si struci, kurse bishtin po e mban lart në Shqipëri”. “Kokën si struci në Kosovë e bishtin e mban lart në Shqipëri. Katër vdekje sot si pasojë e Covid-19, asnjë vaksinë për të shpëtuar jetë njerëzish, madje as edhe një fjalë, veprim apo ndjenjë përgjegjësie e kryeministrit të Kosovës për qytetarët e vet”, ka shkruar Zemaj.



Edhe Eugent Cakolli nga Instituti i Kosovës për Demokraci e ka cilësuar të papranueshëm pjesëmarrjen e kryeministrit Kurti në zgjedhjet në Shqipëri. “Kur dikush në cilësinë e qytetarit të thjeshtë, voton në zgjedhjet e një vendi tjetër, është deri diku e

pranueshme. Por, kur qytetari është dikush që mbart pozitë politike, e madje pushtet ekzekutiv, kjo s’është aspak në rregull. E kur qytetari rastis të jetë kryeministër, që përfaqëson edhe platformë politike për zgjedhjet në vendin tjetër, kjo e bën situatën të papranueshme”,



ka shkruar Cakolli.

Në zgjedhjet e së dielës në Shqipëri ka votuar edhe kryetari i AKR-së, Behgjet Pacolli, kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci dhe disa politikanë të tjerë. Në zgjedhjet e 25 prillit të drejtë vote kanë 3.6 milionë qytetarë. Zgjedhjet e

fundit parlamentare që janë mbajtur në Shqipëri ishin ato të vitit 2017, kur edhe qe regjistruar pjesëmarrja më e ulët historike në zgjedhjet për Kuvendin që nga viti 1991, me 46.76 për qind e qytetarëve që kanë marrë pjesë në këtë proces.



Yuri Kim: Ka ardhur koha që drejtuesit politikë ta presin gjykimin e popullit

Ambasadorja e ShBA-së në Shqipëri, Yuri Kim, ka deklaruar se pjesëmarrja e lartë në zgjedhje tregon se qytetarëve shqiptarë u intereson vendi i tyre. Gjatë

vëzhgimit të procesit zgjedhor në Durrës, ajo u ka bërë thirrje kandidatëve për deputetë dhe drejtuesve politikë, që të presin për rezultatin e zgjedhjeve, pra ta presin

gjykimin e qytetarëve. “Kemi parë pjesëmarrje të lartë. Kjo tregon se qytetarëve shqiptarë iu intereson vendi i tyre. Janë raportuar disa incidente dhe është përgjegjësi e

autoriteteve të hetojnë. Ne e kemi bërë shumë të qartë që të hetohen çështjet deri në fund. Qytetarët janë duke përmbushur detyrën e tyre. Autoritetet janë duke bërë detyrën

e tyre. Tani ka ardhur koha që kandidatët dhe drejtuesit politikë të presin për rezultatet dhe ta presin gjykimin e popullit”, ka deklaruar ambasadorja amerikane.

Kërkohet kompensim për mësimin plotësues



PRISHTINË, 25 PRILL (ER) - Përfaqësuesit e mësimdhënësve po insistojnë që të kompensohen mësimdhënësit të cilët do të angazhohen për mësimin plotësues. Me këtë kërkesë pajtohet edhe drejtori i Shkollës Filllore "Pavarësia" në Prishtinë, Shefki Rusinovci dhe arsimtarja e matematikës po në këtë shkollë, Minivere Tahiri. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka marrë vendim për mbajtjen e mësimin plotësues për nxënësit e arsimit fillor dhe atij të mesëm në Kosovë, për orët e humbura si pasojë e pandemisë së koronavirusit. Rrahman Jasharaj, kryetar i Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK), duke e vlerësuar të nevojshëm realizimin e mësimin plotësues për shkak të ndikimit të pandemisë në mbarëvajtjen e procesit mësimor, thotë se mësimdhënësit nuk janë fajtorë për orët e humbura të mësimin. "Besoj se do arrijmë një marrëveshje të mirëkuptimit me drejtoritë komunale të

arsimit dhe Ministrinë e Arsimit, që këta mësimdhënës për orët shtesë të kenë një kompensim sepse ata edhe ashtu janë të lodhur, të ngarkuar dhe të stresuar nga pesha e stresit të Covid-19. Madje edhe pas shumë kërkesave dhe apeleve të SBASHK-ut, ende nuk është arritur të sigurohet sasi e duhur e vaksinave kundër Covid-19 për punonjësit e sistemit të arsimit", ka thënë Jasharaj për "Radion Evropa e Lirë". Edhe drejtori i Shkollës Filllore "Pavarësia" në Prishtinë, Shefki Rusinovci, ka thënë se do të ishte jonjerëzore që mos të kompensohen këta mësimdhënës. Ai ka thënë se një mësimdhënës i matematikës mban deri në dhjetë orë mësim në ditë dhe, sipas tij, mësimi plotësues do të jetë ngarkesë për ta. "Po e them në mënyrë të qartë, po të ishim duke punuar në rrethana normale, nuk do të ishte diskutuar për pagesa shtesë. Por, në këtë kohë kur mësimdhënësit janë të mbingarkuar me këtë ndarjen e

nxënësve në dy klasa, kur një mësimdhënës i mban dhjetë orë në ditë dhe tashmë me mësimin plotësues, do të ishte jonjerëzore mos të kompensohen. Do të duhej patjetër që të kompensohen sepse vërtet është barrë e rëndë", ka thënë Rusinovci. Kurse arsimtarja e lëndës së Matematikës në Shkollën Filllore "Pavarësia", Minivere Tahiri, pajtohet me kërkesën e SBASHK-ut për pagesë shtesë për mësimin plotësues. Ajo ka treguar për "Radion Evropa e Lirë" se angazhimet dhe përpjekjet për mbarëvajtje të procesit mësimor gjatë kohës së pandemisë nuk kanë munguar edhe pse kjo periudhë, siç thotë ajo, ka qenë sfiduese. "Edhe unë pajtohem me insistimin e SBASHK-ut. Mendoj se ne (mësimdhënësit) jemi të lodhur, të ngarkuar për shkak të ndarjes së nxënësve në dy grupe, edhe pse orët janë më të shkurtra, punojmë në katër ndërrime. Mbajtja e mësimin me orar të shkurtuar është më e vështirë sepse për atë periudhë

mundohemi të shpjegojmë, mos të mbesin nxënësit prapa", ka thënë Tahiri. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nuk ka dhënë ndonjë përgjigje për mundësinë e kompensimit për mësimdhënësit e angazhuar në mësimin shtesë.

Pse mësim plotësues për tri lëndë?

Zyrtarë të Ministrisë së Arsimit, në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë", kanë thënë se nga raportet e Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA) kanë konstatuar se një numër i konsiderueshëm i nxënësve nuk kanë arritur ta përcjellin mësimin dhe të arrijnë t'i përmbushin rezultatet e të nxënësve, të paraparë me programet mësimore-lëndore si pasojë e mungesës së pajisjeve dhe qasjes në internet. Kosova kishte mbyllur institucionet arsimore në muajin mars të vitit të kaluar, kur u paraqitën edhe rastet e para me koronavirus. Mësimi

më pas ishte zhvilluar përmes platformave online dhe mësimëve të transmetuara në televizionin publik.

Edhe rezultatet e jashtme të testit PISA, testit të arritshmërisë dhe testit shtetëror të maturës, thuhet në përgjigje, ku fokus janë lëndët matematikë, gjuhë shqipe dhe shkencat natyrore, është konstatuar se në këtë segment duhet më shumë mbështetje dhe organizim i mësimin plotësues për arritjen e rezultateve.

Ministria e Arsimit nuk e ka përjashtuar mundësinë që në të ardhmen të organizojë mësimin plotësues edhe për lëndë të tjera.

Mësimi plotësues, që do të organizohet për lëndët e gjuhës amtare, matematikë dhe shkencat natyrore, do të fillojë më 3 maj në objekte shkollore dhe do të zgjasë deri në përfundim të vitit mësimor 2020/2021.

Edhe Jasharaj, Rusinovci dhe Tahiri janë pajtuar se mësimi plotësues është i nevojshëm pasi, sipas tyre, pandemia ka ndikuar në procesin mësimor, por sfidë në realizim po paraqitet mungesa e hapësirave për shkak që shkollat janë duke punuar në katër ndërrime dhe me orar të shkurtuar.

Por, zyrtarë të MASHTI-it kanë thënë se kanë përgatitur edhe udhëzuesin për organizimin e mësimin plotësues dhe i njëjti është shpërndarë në drejtoritë komunale të arsimit, në bazë të të cilit do të përcaktohet forma dhe mënyra e organizimit të procesit mësimor.

Mësimi në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar dhe universitar Kosovë që nga muaji shtator i vitit të kaluar është duke vazhduar me pjesëmarrjen fizike të nxënësve në shkolla.

Shënohet rënie e rasteve të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 25 PRILL (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë ndërruar jetë katër persona të infektuar me Covid-19. Po ashtu, IKShPK-ja ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 615 persona dhe janë paraqitur 227 raste të reja me Covid. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë

testuar gjithsej 3 010 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 227 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 4 raste të të vdekurve me SARS CoV-2 pozitiv. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Ferizaj 1 rast (73 vjeç), Rahovec 1 rast (60 vjeç), Shtime 1 rast (72 vjeç), Viti 1 rast (80 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 104 042 raste nga 520 744 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 2 129 raste të të vdekurve. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar



615 pacientë derisa numri i deri më sot është gjithsej 91 427 përgjithshëm i të shëruarve raste, kurse numri i rasteve

aktive është 10 486", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar numrin e rasteve me Covid sipas komunave. "Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 60 raste, Gjakovë 20 raste, Mitrovicë 18 raste, Gjilan 16 raste, Drenas 14 raste, Podujevë 14 raste, Ferizaj 13 raste, Pejë 10 raste, Obiliq 9 raste, Vushtrri 8 raste, Fushë-Kosovë 7 raste, Lipjan 7 raste, Deçan 6 raste, Shtime 6 raste, Malishevë 4 raste, Prizren 4 raste, Klinë 3 raste, Viti 3 raste dhe me nga një rast komunat Hani i Elezit, Kaçanik, Novobërdë, Partesh dhe Skenderaj", ka njoftuar IKShPK-ja.

53-VJETORI I LINDJES SË ISH-PRESIDENTIT HASHIM THAÇI. URIMI I KRYEMINISTRIT TË SHQIPËRISË, EDI RAMA

EDHE 100!

I dashur Hashim,

nuk e di a më lexon dhe nuk di as si je e si shkojnë ditët e tua, në atë izolim krejt absurd ku je i detyruar të qëndrosh për Zoti e di se sa kohë ende! Por unë gjithsesi dua të ta uroj sot ditëlindjen, nga larg dhe me dhimbjen e pamundësisë për ta dëgjuar zërin tënd e bërë shakatë tona me jetën në telefon, po ama besomë, duke u ndier pranë teje më shumë se çdoherë më parë.

Eh, paska qenë e shkruar që ti dhe historia e Kosovës të jeni një, në vuajtje e në gëzime, një simbiozë e hatashme mes një njeriu që i përkushtohet vendit të vet, si një dashurie pa kushte dhe një vendi që e sprovon atë deri në ekstrem. Njëzetë e ca vjet janë shumë fare për njeriun, po për historinë janë sa një ditë dhe përgjatë kësaj dite ti ke provuar lindjen në errësirë, fëmijërinë në agimin e mjegullt, rininë në paraditen e nxehtë përzier me erën e gjakut të shokëve, drekën plot hare e brohoritje fitimtarësh, burrërinë në pasditen e ecjes së gjatë nëpër Kosovë mes

plagëve, halleve e shpresave dhe tash ndalesën pa kohë të muzgut - muzg i njëkohshëm me muzgun që në Kosovë i ngjan një agimi të rrejshëm. Dhe ja, simbioza me historinë e tokës tënde, ty të ka caktuar ta dëshmosh me mungesën atë rrenë, teksa me praninë duhet të përballesh me malin e lartë me rrena që fati yt i shënjuar, ka vendosur përkohësisht mes teje dhe Kosovës tënde në këtë muzg të thellë.

Ti më ke treguar dikur se si numëroje yjet për të mos të të zënë gjumi prej rraskapitjes nëpër shtigjet e luftës, kur ishe një hije në kërkim prej armiqve të tu e të popullit tënd! E tani e marr me mend se yjet duhet t'i kërkosh me zor, nëpër tavanin e ulët që aq shumë i ngjan qiellit të Kosovës së sotme. Por duke ta njohur fortësinë e materialit me të cilin je gatuar, nuk e kam të pamundur të marr me mend durimin e pathyeshëm, me të cilin ti arrin ta mbash mbi vete atë tavan poshtëruës, pa e përkulur trupin e imagjinatës



tënde.

Nuk e di sa do të zgjasë nata që ke përpara, miku im i shtrenjtë, por ajo çfarë di njësoj si drita e diellit mbi Tiranë sot, është se agimi do të vijë përsëri, për ty e për Kosovën. E di vëlla, e di, që vitet deri në agim janë minuta për historinë, po jo për jetën e njeriut të kyçur me pahirin e cinizmit njerëzor brenda katër mureve dhe mundohem ta marr me mend, se sa e rëndë

është për ty pamundësia për të ecur edhe me këmbë, e jo veç me mendje nëpër rrugët e pyjet e Kosovës. Por s'ke kurrëgjë çka bën, ti u rrite e u bërë burrë e babë, po askurrë s'e pate dot në dorë të jesh tjetësend përveçse kukulla e fatit tënd të bërë njësh me Kosovën.

Kështu që ma fal nëse ky urim i imi, me gjithë shpirt, që edhe 100 vjet t'i kesh me shëndet e me kë të do zemra, nuk është dot një urim i buzëqeshur por, pashë

Zotit e madh, mos iu anko fatit tënd e as mos kërkko kot ta dish se si mund të ishte ndryshe, sepse sado cinike të të duket, nuk kishte se si të ndodhte ndryshe që Kosova të mund të buzëqeshë përsëri, kur përsëri nata t'ia lerë vendin ditës së re! Përqafime Hashim dhe jam atje, me ty sonte, kur t'i kujtosh dollitë e shkuara në familje, për këtë ditëlindje të pamirëseardhur nën tavanin e mallkuar!

Grupi marksist leninist i Kosovës dhe demonstratat e vitit 1981



Shkruan: Ismail SYLA

1. Në 40-vjetorin e demonstratave të vitit 1981 vërehen paraqitje publike nga më të ndryshmet, prej atyre serioze deri tek ato shpesh qesharake, të përcipta, të turbullta dhe opake. Të vjen gërdi prej paraqitjeve të gjymta në disa raste, kur gazetari i një brezi të ri në bashkëbisedim me disa përfaqësues të shpifur të demonstratave të vitit 1981, në vend që të dalë i ndriçuar nga debati televiziv, del konfuz, e aq më konfuze dalin shpjegimet lidhur me demonstratat e vitit 1981.

2. Grupi i organizuar në ilegalitet të thellë në vitet 1970 deri më 1981, Grupi Marksist Leninist i Kosovës (i shndërruar në Organizatë Marksiste Leninate të Kosovës OMLK) në kuptimin strategjik dhe faktik nuk ka të bëjë asgjë me organizimin e demonstratave të 11, 26 marsit,

1 dhe 2 prillit 1981. Anëtarët e GMLK-së mund të kenë marrë pjesë në demonstratat e vitit 1981, individualisht, por në programin politik të GMLK-së së vitit 1981 nuk kanë qenë fare në agjendë, as si strategji, as si taktikë, as si ide as si plan operacional.

3. GMLK-ja ka qenë një organizatë e fshehtë, e përsosur si strukturë dhe organizim me program politik ideal brenda vetvetes. Në bazë të kësaj përsosmërie ka mundur të qëndrojë dhe jetojë për shumë e shumë vite pa u zbuluar nga shteti jugosllav, por ndikimi i saj në praktikë do të ishte i vogël dhe pa efekt cilësor në largimin e sundimit jugosllav të Kosovës. Qëllimi i saj, çlirimi i Kosovës dhe bashkimi me Shqipërinë ka qenë synim po ashtu ideal, por koha ka treguar se ai idealizëm dhe ai organizim ka qenë në një gjendje sterile politike. Kur GMLK-ja fillon të shpërndajë më shumë material propagandistik, antijugosllav, pra kur fillon të dalë përtej ilegalitetit steril, ndodh zbulimi dhe arrestimi i anëtarëve të saj, që nga nëntori 1981.

4. Në mënyrë telegrafike

trashëgimia kryesore politike e GMLK-së mbeten traktet e shpërndara me përmbajtje antijugosllave dhe me orientim të pastër kombëtar, që kulmojnë me traktin për 100 vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (10 qershor 1978) dhe me vizitën e shefit të shtetit jugosllav, Josip Broz Tito në nëntor 1979 në gjashtë qendrat urbane të Kosovës. Brenda fushëveprimit të GMLK-së ka qenë organi ideologjik "Pararoja", gazeta "Liria" dhe libri "Këngët e lirisë".

5. Jetëgjatësia e mos zbulimit të GMLK-së është pasqyrë e veprimeve në kushte sterile të fshehtësisë. Objektivi ideal i GMLK-së ka qenë vetëdijesimi kombëtar i popullit të Kosovës për robërinë nën Jugosllavi dhe organizimi i një kryengritjeje të armatosur, që do të çonte në çlirimin e Kosovës dhe bashkimin e saj me Shqipërinë. Koha ka dëshmuar se asnjëherë nuk arrihet ndërgjegjësimi i tërë shoqërisë për të ndërmarrë veprime tërësisht kolektive. Shpesh ngjarje parçiale, xixa e shkreptima politike kanë tërhequr veprime tektonike. Kulmi iluzionist i vetëdijesimit tërësor të komunitetit, kombit, popullit së pari dhe pastaj rrokja

e armëve nga i gjithë populli për ta nisur luftën, në praktikën e pa bërë praktikë shpjegohet me synimet e Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK).

6. Personifikim dhe ikonë e demonstratave të vitit 1981 është studenti i vonuar Ali Lajçi. Fjalimi i tij më 11 mars 1981 sado i varfër politikisht, pa strukturë dhe pa ndonjë koherencë ka zënë momentin historik dhe Ali Lajçin e bën përfundimisht simbol të demonstratave të vitit 1981. Ende nuk besoj se ka një bërthamë të vetëdijshme organizative me objektiva të qartë politike për organizimin e demonstratave të 11 marsit, të 26 marsit si dhe të 1 dhe 2 prillit 1981. Demonstratat e vitit 1981 janë rezultat i emancipimit kombëtar të inteligjencies rinore dhe universitare, të mbujtur përgjatë viteve 1970. Janë rezultat i elektrizimit general të vetëdijes kombëtare, të cilën edhe një veprim spontan krijon reagim kundër strukturave sunduese të Kosovës (administratës jugosllave, policisë, komitetit komunist, ushtrisë "popullore" etj.) Disa të vetëquajtur organizatorë më shumë janë menaxhues të gurëve, hunjve

dhe objekteve protestuese në rrugët e Prishtinës, se të një planifikimi të mirëfilltë.

7. Ndikimi i GMLK-së praktikisht në shpërthimin e demonstratave të vitit 1981 është zero. Kjo nuk do të thotë se po të mos shpërthenin demonstratat e vitit 1981 GMLK-ja nuk do të organizonte protesta dhe veprime tjera me karakter klasor e kombëtar. Derisa fjalimi i Ali Lajçit te udhëkryqi i Menzës së Studentëve është inaugurues i shpërthimit të demonstratave, fjalimi i Hydajet Hysenit në bli është plotësisht individual, nuk ka të bëjë si ndikim i para planifikuar i GMLK-së. Ai është militant i GMLK-së, por nuk është demonstrata e GMLK-së. Ali Lajçi mbetet ikonë e demonstratave të vitit 1981, e asaj fryme patriotike gjenerale, ndonëse individët e organizuar në organizata klandestine e konsiderojnë vetveten më meritorë, vetëm pse kanë qenë të organizuar.

8. **Si përfundim:** Organizimi klandestin mund të jetë i përsosur por kontributi matet me veprim dhe ndikim publik. Jo me përsosmëri sterile.

Gjermania dhe Italia, vendet kryesore të tregtimit me Kosovën

Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka bërë me dije se eksporti i mallrave në muajin mars të këtij viti kishte kapur vlerën e 61.8 milionë euro, ndërsa importi 382.5 milionë euro. Sipas ASK-së, këto shifra tregojnë për një rritje prej 92.2-përqindësh për eksport dhe 51.8 për qind për import. Ndërsa sa iu përket eksporteve dhe importeve të Kosovës në vendet e BE-së, partneret kryesore janë Italia dhe Gjermania



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 PRILL - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin mars të vitit 2021. Të dhënat nga tregtia e jashtme të mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 45.8 për qind në muajin mars, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2020, gjegjësisht në vlerë prej 320.7 milionë eurosh, krahasuar me deficitin prej 219.9 milionë eurosh sa ishin në vitin 2020. Eksporti mbulon importin me 16.2 për qind. Sipas ASK-së, eksporti i mallrave në muajin mars 2021 kishte vlerën 61.8 milionë euro, ndërsa importi 382.5 milionë euro, që është një rritje prej 92.2-përqindësh për eksport dhe 51.8 për qind për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020. "Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 35.1 për qind të eksporteve e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej

tyre; 17.2 për qind e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; 9.5 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 7.3 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 7 për qind e përbëjnë produktet minerale; 5.5 për qind e përbëjnë tekstili dhe artikujt prej tij; 4.2 për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike, etj", është thënë në raportin e ASK-së.

Referuar këtij raporti, grupet kryesore të importit i përbëjnë: makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike, produktet minerale, ushqimet e përgatitura, si dhe pijet dhe duhani. "Sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 12.6 për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 11.9 për qind e përbëjnë produktet minerale; 11.7 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 9.9 për qind e përbëjnë mjettet e transportit; 9.8 për qind e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 9.3

për qind e përbëjnë produktet e industrisë kimike; 7.5 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre, etj", është thënë në raportin e ASK-së.

Kurse sa iu përket eksporteve dhe importeve të Kosovës në vendet e BE-së, partnerët kryesore janë Italia dhe Gjermania. "Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 19.8 milionë euro, ose rreth 32.2 për qind e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 82.8-përqindësh. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Italia (10.6 për qind), Gjermania (7.1 për qind), Holanda (2.5 për qind), etj. Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 184.8 milionë Euro, ose 48.3 për qind e importeve të përgjithshme,

me një rritje prej 38.8 për qind. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (14.8 për qind), Italia (6.1 për qind), Greqia (5.9 për qind), Sllovenia (3.6 për qind), etj.", është thënë në raportin e ASK-së.

Sipas ASK-së, në muajin mars 2021 eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-së arritën në 24.3 milionë euro, ose 39.4 për qind të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 53.4-përqindësh. "Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-së ishin: Shqipëria (16.2 për qind), Maqedonia e Veriut (12.2 për qind), Serbia (5.8 për qind) dhe Mali i Zi (3.3 për qind). Ndërsa importet nga vendet e CEFTA-së në muajin mars 2021 arritën në 71.3 milionë euro, ose 18.6 për qind

të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 146.9-përqindësh. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Serbia (5.9 për qind), Maqedonia e Veriut (5.6 për qind) dhe Shqipëria (5.5 për qind). Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 17.5 milionë euro, ose 28.5 për qind. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport vlen të përmendën: ShBA-ja (14.3 për qind) dhe Zvicra (7.8 për qind), ndërsa importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 126.3 milionë euro, ose 33.0 për qind. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (12.8 për qind) dhe Kina (8.7 për qind)", është thënë në fund të raportit.

AAK-ja fton në interpelancë ministrin Murati për uljen e shtesave për pensionistët

PRISHTINË, 25 PRILL (ER) - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka thënë se qeveria Kurti u ka bërë një padrejtësi të madhe pensionistëve të cilët, sipas tij, janë kategoria shoqërore që rrezikohen më së shumti nga Covid-19. Në këtë kontekst, Tahiri ka bërë me dije se për shkak të uljes së shtesave të pensionistëve, AAK-ja ka vendosur që ta thërrasë në interpelancë ministrin e Financave dhe Transfereve, Hekuran Murati. "Javën e kaluar ishim dëshmitarë të një padrejtësie që iu bë pensionistëve nga Qeveria e Kosovës. Nuk mjaftoi paaftësia për t'i siguruar vaksinat për ta. Kjo kategori shoqërore është kategoria më e rrezikuar nga Covid-19. Për ta rënduar edhe më tej gjendjen e tyre, tani edhe

në aspektin financiar, përveç atij shëndetësor, kjo qeveri paturpësisht vendosi t'i ulë shtesat e pensioneve për ta për 1/3 nga shtesa e merituar nga qeveria e kaluar. Ky vendim e dëmton tejmas gjendjen e pensionistëve, që njihet si kategoria me gjendjen më të rëndë sociale. Të shtyrë nga gjendja e tyre e rëndë, por edhe nga bisedat me ta, të cilët ndihen të mashtruar dhe të zhgënjyer me këtë qeveri, grupi parlamentar i AAK-së do ta ftojë në interpelancë në Kuvendin e Kosovës ministrin e Financave, Hekuran Murati, për të dhënë llogari për këtë vendim zhgënjës. Përveç që është jonjerëzore, është mashtrim që të marrësh vota me premtime për rritje të pensioneve e t'i ulësh ato që në ditët e para të qeverisjes", ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në "Facebook".



Gastronomët kërkojnë subvencionim në bazë të performancës

PRISHTINË, 25 PRILL - Kryetari i Shoqatës i Gastronomëve, Petrit Klllokoqi, ka deklaruar se kanë qenë kundër pakos së qeverisë Hoti me të cilën është bërë subvencionimi kolektiv dhe se tani e tutje subvencionimi duhet të bëhet në bazë të performancës.

Klllokoqi ka thënë se tani presin nga qeveria e re të klasifikojë dhe kategorizojë bizneset që do të ndihmohen pasi për shkak të ndarjeve të gabuara nga qeveria e kaluar i bie që bizneset e mbyllura tash e 430 ditë janë subvencionuar vetëm një herë.

Ngritja e çmimeve me marrëveshje nga disa biznese të gastronomisë, Klllokoqi ka thënë se nuk është hera e parë që ndodh dhe se ata si shoqatë distancohen nga ky veprim. Petrit Klllokoqi ka fajësuar

qeverinë Hoti për ndarje të gabuar të pakos emergjente. Ai ka thënë për "Kosovapress", se me subvencionimin kolektiv që është bërë nga qeveria e kaluar, bizneset si klubet e natës dhe sallat e dasmave, i bie që janë subvencionuar vetëm një herë.

"Ne jemi shprehur se jemi kundër çdo subvencionimi kolektiv. Në këtë rast kemi kërkuar që në bazë të performancës të subvencionohen bizneset. Nëse një biznes, një sallë e dasmash, nuk ka punuar që 430 ditë, nuk mund të krahasohet me një barnatore që ka pasur një performancë të mirë... Kemi qenë kundër që të përfitojmë njëjtë. Shkaku i këtyre ndarjeve të gabueshme ne mund të themi se jemi subvencionuar vetëm një herë

e jemi që 430 ditë mbyllur me vendim të qeverisë, po flas për klubet e natës, sallat e dasmave dhe për biznese të tjera. Kështu që nuk ka qenë e drejtë dhe nuk duhet të jetë e drejtë. Po shpresoj se kjo qeveri do t'i klasifikojë dhe kategorizojë më mirë këto lloje të bizneseve se si do të ndihmohen", ka thënë Klllokoqi.

Më tutje, ai ka thënë se me ministrin e Financave, Hekuran Murati, duhet të shikojnë se si do të ndihmohen bizneset që kanë qenë të mbyllura deri më tani. "Me bisedën që e kemi pasur me ministrin Murati dhe zëvendësministrin e Financave kemi diskutuar që të subvencionohet gjysma e pagës së deklaruar. Edhe nëse dikush e ka një vlerë më të madhe të pagës do të

subvencionohet. Ndërsa pastaj ndërroi vendim dhe doli që maksimumi do të jetë 500 euro subvencionimi. Kështu që nuk jam pajtuar me ata", është shprehur ai.

I pyetur lidhur me ngritjen e çmimeve nga disa biznese të gastronomisë dhe për reagimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës se kanë vendosur që bashkërisht me marrëveshje t'i ngritin çmimet e kafeve dhe produkteve të tjera, Klllokoqi ka thënë se Shoqata e Gastronomëve distancohen nga ky veprim. "Autoriteti i Konkurrencës është më mirë me u marrë me disa punë të tjera, edhe me i lënë gastronomët, se tash janë goxha me një hall të madh dhe nuk është që jemi duke fol për një kafe që është bërë prej 1 euro në 10 euro. Nuk është që i

mbrojmë. Ne si Shoqatë e Gastronomëve distancohemi çdoherë prej mbledhjeve që bëhen. Ka urndodh edhe në të kaluarën që janë mbledhur në një rrugë edhe krejt bashkërisht e kanë ngritur çmimin e një produkti. Ne nuk jemi për, mirëpo bizneset individualisht mund të veprojnë në ngritje të çmimeve të tyre. Ato janë politika brenda bizneseve. Nëse unë dua, në restorantin tim mund ta bëj 100 euro kafen. Tani veç nuk më vjen kurrkush, kështu që secili biznes mund të veprojë për biznesin e vet ashtu si të shohë të arsyeshme. Sa iu përket marrëveshjeve të ndryshme, ku mund të grumbullohen ato, nuk i pëlqejmë ne si shoqatë dhe distancohemi", ka thënë Klllokoqi.



Borxhi publik i Britanisë së Madhe arrin nivelin më të lartë që nga viti 1947

LONDËR, 25 PRILL - Në Britaninë e Madhe huamarrja publike ka arritur në 303.1 miliardë paundë vitin e kaluar. Zyra Britanike e Statistikave (ONS) ka njoftuar se huamarrja totale publike në vend nga prilli 2020 deri në fund të marsit 2021 u rrit me 246.1 miliardë paundë në 303.1 miliardë paundë. ONS-ja ka theksuar se ky është borxhi më i lartë publik me bazë vjetore që nga marsi i vitit 1947. Më tutje është theksuar se në mars të vitit 2021, Britania ka huazuar në nivelin e 28 miliardë paundë, duke përjashtuar bankat publike dhe është regjistruar një rritje

prej 21 miliardë paundësh në bazë mujore në krahasim me të njëjtin muaj të vitit të kaluar. Sipas të dhënave të ONS-së, në fund të marsit 2021 borxhi i përgjithshëm publik i Britanisë së Madhe, duke përjashtuar bankat publike, është rritur në një total prej 2 trilionë e 141 miliardë paundësh. Kjo barazohet me 97.7 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto të vendit. Në mars të vitit 2020 qeveria britanike kishte vendosur të paguajë 80 për qind të pagave qytetarëve, me kusht që të mos kalojnë 2 500 paundë për ata që nuk punojnë për shkak të pandemisë Covid-19.



“Armagedoni” i dhuroi libra Komunës së Klinës

KLINË, 25 PRILL (ER) - Shtëpia botuese “Armagedoni”, e cila drejtohet nga Berat Dakaj, të premtën, më datë 23 prill, në Ditën Ndërkombëtare të Librit dhe të Drejtës së Autorit, ka dhuruar për Drejtorinë e Kulturës të Komunës së Klinës, për bibliotekën publike dhe ato shkollore, rreth 500 ekzemplarë të librave, të autorëve shqiptarë dhe të huaj.

Drejtori i Kulturës në Komunën e Klinës, Skender Merturi, i cili ka bërë pranimin

e librave, ka falënderuar drejtorin e shtëpisë botuese “Armagedoni”, Berat Dakaj, për dhurimin e këtyre librave të cilat do ta pasurojnë bibliotekën e qytetit.

Edhe kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, ka falënderuar shtëpinë botuese “Armagedoni” për dhurimin e librave për bibliotekat e Komunës së Klinës. “Sot, në Ditën Ndërkombëtare të Librit dhe të Drejtës së Autorit, shtëpia botuese ‘Armagedoni’, e cila udhëhiqet nga

bashkëvendësi ynë nga Caraviku, Berat Dakaj, dhuroi për Komunën e Klinës, për bibliotekën publike dhe shkollore, rreth 500 ekzemplarë të librave, të autorëve shqiptarë dhe të huaj. Falënderoj Beratit për dhurimin e këtyre librave të cilat do ta pasurojnë bibliotekën e qytetit. Po ashtu, me qëllim që t’i plotësojmë kërkesat e lexuesve, Komuna ka filluar procedurat për furnizim me tituj të rinj për bibliotekën e qytetit.



Aliu sërish kandidon për kryetar të Ferizajt: Është koha të ndryshojë PDK-ja

FERIZAJ, 25 PRILL - Kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, ka thënë se kjo komunë do të jetë në konkurrencë me qytetet e rajonit edhe për katër vjetet e tjera, duke konfirmuar kandidimin e tij edhe për një mandat tjetër. “Unë asnjëherë nuk kam parë kundërkandidatë dhe rivalë. Unë e kam parë vetëm veten time, platformën time dhe ofertën e përgjegjshme që duhet t’u jap qytetarëve të mi. Këtë e kam bërë në çdo angazhim dhe kandidaturën timen, thjesht kam dashur ta paraqes pastaj t’u mbetet qytetarëve të vendosin. Jam i bindur që sërish do të ndodh kështu”, ka thënë Aliu për “EO”.

Më tutje, Aliu, i cili është nënkryetar i PDK-së, ka folur edhe për zhvillimet në këtë parti. Me këtë rast, ai ka thënë se tani është koha që PDK-ja të ndryshojë. “Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka kohë që ka filluar ndryshimet. Ritmi i ndryshimeve duhet vazhduar dhe duhet një ndryshim esencial, një ndryshim thelbësor. Sigurisht se është vështirë për t’u bërë e



gjitha ajo që është kërkesë e elektoratit, por edhe e qytetarëve, sepse PDK-ja është duke kaluar në një periudhë ku mungon

leadershipi i saj, dhe sigurisht është e vështirë të bëhet gjithë ajo që e thashë që është kërkesë”, ka thënë ai.

Familja Ibishi nga Skenderaj dhuron 5 000 kilogramë miell për familjet në nevojë



SKENDERAJ, 25 PRILL (ER) - Xhafer Murtezaj, profesor dhe veteran i arsimit, së bashku me hoxhën e Runikut, Korab Hajra, kanë bërë dorëzimin e donacionit të pesë djemve të Imer Ibishit, me banim në Londër, të cilët kanë dhuruar 5 mijë kilogram miell për familjet në nevojë të kësaj komune. Pas pranimin të këtij donacioni, kryetari Bekim Jashari, në emër të qytetarëve

të Skenderajt, ka falënderuar Qazimin, Hysniun, Enverin, Nexhmedinin dhe Selimin për përkrahjen e ofruar për familjet nevojtare. Më tutje, Jashari ka thënë se të gjitha donacionet të cilat janë duke u dhuruar nga njerëzit e vullnetit të mirë do të shpërndahen përmes Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si dhe Qendrës për Punë Sociale.

Nënshkruhet marrëveshja për projektin më të madh turistik në Kamenicë

Kamenicë, 25 prill (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, bashkë me përfaqësuesin e “Kika Hills”, Drilon Qehaja, kanë nënshkruar marrëveshjen për projektin më të madh turistik në Kamenicë që nga paslufta.

“Kika Hills”, që ka vlerën mbi gjashtë milionë euro, do të implementohet në Kikë dhe do të jetë qendër rekreative jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë. Projekti në fjalë do të përfshijë hotelin, restaurantin, hapësirat rekreative, shtegun për ecje, çiklizëm, hapësira për piknikë e sport, villa, kopsht zoologjik etj.

I pari i Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka thënë se ky është një nga projektet më atraktive e inovative të turizmit. “Kamenica ka një pozitë shumë të mirë gjeografike dhe potencial për zhvillimin e turizmit sepse 70 për qind e territorit është kodrinor-malor. Nënshkrimi i marrëveshjes për dhënien e pronës në shfrytëzim është i periudhës afatgjatë dhe ky projekt ka vlerën mbi gjashtë milionë euro”, tha ai. Sipas Kastratit, nga kjo marrëveshje që do të gjenerojë edhe vende të reja të punës, do të ketë së paku 70 të punësuar, ku është kërkuar që 30 për qind prej tyre të jenë gra dhe 5 për qind persona me nevoja të veçanta.

Ndërsa përfaqësuesi i “Kika Hills”, Drilon Qehaja, ka falënderuar kryetarin Kastrati për qasjen ndaj këtij projekti si dhe komisionin për profesionalizimin gjatë gjithë kësaj periudhe. Sipas tij, ky projekt mund të jetë motor i zhvillimit ekonomik e turistik për Kamenicën. “Është shumë kënaqësi që pas shumë kohe së vepruari në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të vij në vendlindje për një investim të tillë. Ky projekt do ta vendosë Kamenicën në hartë turizmi edhe në nivel rajonal dhe për këtë falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët”, ka thënë ai. Në anën tjetër, drejtoresha për Zhvillim Ekonomik dhe



Diasporë, Majlinda Krasniqi, ka thënë se ndihet jashtëzakonisht mirë që ky projekt madhor do të implementohet në Kamenicë.

Në komisionin për këtë projekt, kanë qenë të përfshirë anëtarë nga Kuvendi Komunal i Kamenicës, shoqëria civile dhe ekspertë të fushës.

CERN dhe FERMILAB kërkojnë forcën e pestë fundamentale të fizikës, që tashmë është zbuluar nga fizikani Naim Krasniqi

Sot unë as që do të ishte dashur të reagojë për përpjekjet e shumë qendrave për hulumtime shkencore që dalin me botime se janë duke e zbuluar grimcën e re apo forcën fundamentale të re, duke e përfshirë edhe CERN - The European Organization for Nuclear Research në Evropë dhe FERMILAB - Fermi National Accelerator Laboratory në ShBA. Këto dyja (CERN dhe FERMILAB) sot flasin për atë që tashmë është e zbuluar nga unë, Naim Krasniqi. Krenaria më e madhe për mua do të ishte sikurse dikush tjetër, qoftë individ, grup, universitet apo institut të reagoje para meje, jo për të më përkrahur vetëm mua si një person por për ta përkrahur gjeneratën e tanishme dhe të ardhshme mbi të vërtetën nga e cila do të fitonim i gjithë njerëzimi. Ky reagim i imi ndaj CERN dhe FERMILAB dhe që është në mbrojtje të zbulimit tim, që dikush tjetër po tenton ta kërkojë forcën e pestë fundamentale të fizikës, e cila tashmë është zbuluar nga unë dhe kam shkruar për të, do të botohet në disa vazhdimë në gazetën e përditshme "Epoka e re", e cila që në fillim më ka dhënë hapsirën për të prezantuar zbulimin tim shkencor në këtë fushë



Nga: Naim KRASNIQI, fizikan

Reagim ndaj qendrave hulumtuese CERN dhe FERMILAB

Një përmbledhje e këtyre shkrimeve vjen në këtë kohë pas informacioneve që vijnë nga Qendra Europiane për hulumtime bërthamore CERN që ndodhet në kufirin mes Francës dhe Zvicrës, si dhe nga qendra kërkimore

FERMILAB që ndodhet në shtetin Illion të ShBA-ve, dhe që është një laborator i fizikës së grimcave me energji të lartë, përndryshe energjisë bërthmore. Bazuar në informacionet zyrtare nga këto qendra hulumtuese shkencore theksohet se pasi të kenë kryer eksperimente në laboratorët e tyre eksperimentalë, janë afër zbulimit të një grimce të re, apo një force të re fundamentale në realitetin atomik si dhe në univers, e cila grimcë apo forcë ndikon në rënien e modelit standard të fizikës së grimcave dhe shkon drejt formimit të një fizike të re. Kur është fjala te grimca e re kuptohet se ajo formon një fushë, e fusha formon një forcë, e cila forcë sot njihet si

forca e pestë fundamentale e fizikës. Këtë forcë të pestë fundamentale me dekada e kanë kërkuar më parë shkenctarë, duke e përfshirë edhe Anshajnin i cili kishte punuar në këtë drejtim. Por këtë forcë janë duke e kërkuar edhe tani shumë shkenctarë dhe qendra për hulumtime shkencore anekënd botës, nga fakti se në mungesë të moszbulimit të kësaj force modeli standard i fizikës së grimcave po përballet me paaftësinë e saj për ta shpjeguar përbërjen e energjisë së zezë e cila përbën rreth 95 për qind të universit. Pasi këtu flitet për rënien e modelit standard të fizikës së grimcave, le ta sqarojmë në pika të shkurtëra se çfarë përmban ky model.

Modeli standard i fizikës së grimcave

Modeli standard i fizikës së grimcave është teoria fizike që i përshkruan grimcat përbërëse të materies si dhe forcat e bashkveprimeve fundamentale.

1) Grimcat e materies sipas modelit standard të fizikës së grimcave.

Sipas fizikës tradicionale materia përbëhet nga 12 grimca elementare të ndara në tri familje apo gjenerata

6 kuarke: (Up/lartë, Down/poshtë, Charm, Top, Strange, Bottom) si dhe

6 Leptone: 3 elektrone (elektron, muon, tauon) si dhe 3 neutrine (Elektronike, mounike dhe taunike).

(Shiko figurën 1.)

Familja e parë: janë stabile dhe përbëhen nga kuarket (Up/lartë dhe Down/poshtë) si dhe leptonet (Neutrino elektronik dhe elektronet)

Familja e dytë: Nuk janë stabile dhe përbëhen nga kuarket (Charm dhe Strange) si dhe leptonet (neutrino monike dhe muonet)

Familja e tretë: Nuk janë stabile dhe përbëhet nga kuarket (Top dhe Bottom) si dhe leptonet Neutrino tauike dhe Tau).

2) Forcat e bashkveprimit bazuar në modelin standard të fizikës së grimcave

Universi mbizotërohet nga katër forca themelore që

posedojnë intensitete të ndryshme:

a) Forcat e forta apo interaksioni i fortë nuklear barten përmes gluoneve, janë forca që veprojnë në mes të grimcave që posedojnë kuarke, siç janë protonet dhe neutronet në bërthamën e atomit.

b) Forcat elektromagnetike apo interaksioni elektromagnetik, janë forca më të vogla se forcat e forta nukleare, por më të forta se sa forcat e dobëta dhe forcat gravitacionale. Këto forca barten përmes fotoneve dhe kanë lidhshmëri në mes të elektroneve dhe bërthamës së atomit. Këto forca mund të jenë shtytëse dhe tërheqëse dhe veprojnë në mes të grimcave elektrike pa marrë parasysh a janë në qetësi apo në lëvizje. Dhe si të tilla mund të jenë fenomene elektrike, magnetike, të dritës si dhe reaksione kimike që veprojnë në mes të elektroneve që janë grimca elektrike negative dhe bërthamës së atomit me ngarkesë elektrike pozitive.

c) Forcat e dobëta apo nganjëherë siç quhen forcat e dobëta nukleare, të cilat barten përmes bosoneve W dhe Z. Janë fenomene fizike natyrale gjatë të cilave bërthamat atomike jostabile desintegrohen në mënyrë spontane duke liruuar energji në formë të rrezatimeve. Efekti më i njofshëm te forcat e dobëta është radioaktiviteti beta.

Forcat gravitacionale njihen si forcat më të dobëta në krahasim me forcat e tjera të bashkëveprimit.

Siç po shihet modeli standard i fizikës së grimcave përfshinë forcat e forta, forcat elektromagnetike, si dhe forcat dobëta, por nuk i përfshinë forcat gravitacionale edhe pse luajnë një rol dominant në univers, prapë se prapë këto forca nuk janë pjesë e modelit standard të fizikës së grimcave.

Në fakt, hyrja e kësaj force në modelin standard u tregua e vështirë, nga fakti se teoria kuantike e përdorur për të përshkruar botën mikroskopike dhe teoria e përgjithshme e relativitetit, e përdorur për të përshkruar botën makroskopike, nuk mund ta zgjidhin dot këtë problem. Në këtë mënyrë ligjet e fizikës së mikrobotës nuk zgjidhin problemin e makrobotës, por as ligjet e fizikës së makrobotës nuk zgjidhin problemet e fizikës së mikrobotës.

(Vijon)

	Leptonet		Kuarket	
	0	-1e	+2/3 e	-1/3 e
Gjenerata e parë	ν_e Neutrinet Elektronike	e Elektronet	u Kuarket Up	d Kuarket Down
Gjenerata e dytë	ν_μ Neutrinet Monike	μ Muonet	c Kuarket charm	s Kuarket strange
Gjenerata e tretë	ν_τ Neutrinet Tauike	T Tau	t Kuarket top	b Kuarket bottom

Figura 1

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Prishtina fiton derbin ndaj Dritës, Ballkani merr kreun

Superliga vazhdon të bëhet edhe më interesante, pasi Prishtina mposhti në derbi Dritën dhe ngushtoi diferencën e pikëve e, në anën tjetër, Ballkani e mori kreun falë fitores ndaj Gjilanit. Llapi ka regjistruar edhe një sukses, pasi e ka mposhtur Trepçën '89



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 25 PRILL - Prishtina e ka fituar derbin e madh ndaj Dritës (1-2), i cili është zhvilluar sot në qytetin e Gjilanit. Ishte skuadra kampione ajo që shënoi e para në minutën e 21-të, kur Betim Haxhimusa realizoi për 1-0. Në minutën e 35-t Endrit Krasniqi e barazoi rezultatin në 1-1. Golin e fitores për skuadrën kryeqytetase e shënoi Besnik Krasniqi në minutën e 71-të. Drita mbetet në kuotën e 64 pikëve, derisa Prishtina ngrehet në kuotën e 63 pikëve dhe zë pozitën e tretë. Në ndeshjen tjetër Ballkani e ka mposhtur Gjilanin me rezultat 1-0. Skuadra nga Suhareka ka pasur më shumë raste dhe me meritë ka marrë tri pikët e plota në këtë ndeshje. Edhe Gjilani pati disa raste shënimi, por nuk arriti të shënojë gol. Golin e vetëm në ndeshje e realizoi zëvendësuesi Mevlan Zeka në minutën e 71-të. Tash skuadra e Ballkanit ka grumbulluar 64 pikë, aq sa ka

edhe Drita. Ndërsa Gjilani mbetet në pozitën e katërt me 43 pikë. Fitores i është gëzuar edhe Llapi në përballje me Trepçën '89 (2-1). Në pjesën e parë mysafirët kaluan në epërsi

SUPERLIGA - Java 30		
Drita - Prishtina		1-2
Ballkani - Gjilani		1-0
Llapi - Trepça '89		2-1
Arbëria - Besa		2-1
Drenica - Feronikeli	1-1	

Tabela		
	Pikë	
1. Ballkani	30	64
2. Drita	30	64
3. Prishtina	30	63
4. Gjilani	30	43
5. Llapi	30	39
6. Feronikeli	30	35
7. Trepça '89	30	35
8. Drenica	30	34
9. Arbëria	30	30
10. Besa	30	10

Në xhiron e radhës takohen: Feronikeli-Arbëria, Prishtina-Trepça '89, Gjilani-Drenica, Ballkani-Llapi, Besa-Drita.

me golin e Muharrem Jasharit, por në pjesën e dytë Llapi e përmbysi rezultatin me golat e shënuara nga Ardit Peposhi (49') dhe Valmir Veliu (60'). Llapi përforcon pozitën e pestë me 39 pikë, kurse Trepça '89 është në vendin e shtatë me 35 pikë. Të shtunën janë zhvilluar dy ndeshje. Drenica ka barazuar në shtëpi në duel me Feronikelin me rezultat 1-1. Kuqezinjtë arritën t'i shmangen humbjes me golin e shënuar në minutat shtesë, kur Kreshnik Uka

realizoi me gjuajtje të shkëlqyeshme nga ndërprerja. Feronikeli kishte epërsi që nga minuta e parë me golin e Marko Simonovskit pas asistimit të Silvas. Pas këtij barazimi, Drenica renditet e teta me 34 pikë (pozitë kjo që çon në barazh), ndërsa Feronikeli me 35 pikë mban pozitën e gjashtë. Në ndeshjen tjetër, skuadra e parafundit në renditje, Arbëria, ka arritur të kthehet te fitorja, duke e mundur skuadrën e fundit në renditje dhe pa

shpresë për mbijetesë në elitë, Besën, me shifrat 2-1. Të parët në epërsi kaluan pejanët me golin e Etnik Brrutit në minutën e 52-të, por vendasit u kundërpërgjigjen shpejt dhe në minutën e 65-të barazuan shifrat me golin e Santos, derisa në minutën e 85-të Hysen Bytyqi shënoi golin e fitores. Edhe pas këtij triumfi Arbëria mbetet në vendin e nëntë me 30 pikë, por mban gjallë shpresat për t'iu shmangur rënies nga elita.

Sonte mund të vendoset titulli në Superligën e Femrave



PRISHTINË, 25 PRILL - Sonte (e hënë) do të zhvillohet ndeshja e katërt e "play-off"-it në EBC Ligën e Femrave ndërmjet Penzës dhe Bashkimit. Skuadra prizrenase është në epërsi 2:1. Nëse fiton këtë përballje do të stoliset me titullin e kampionit, kurse nëse fiton Penza do të zhvillohet edhe

ndeshja e pestë. Skuadra që shënon tri fitore shpallet kampione e EBC Ligës së Femrave. Takimin e parë e fitoi skuadra pejane 63:84, kurse në dy ndeshjet e tjera fituan vashat prizrenase 65:70 dhe 74:63. Sfidat finale ishin mjaft interesante dhe kështu pritet edhe të hënë mbrëma. Në

garat e rregullta, këto dy skuadra u përballën katër herë, ku tri herë fitoi Bashkimi dhe një herë Penza. Bashkimi ishte edhe në finale të Kupës, ku u mund nga Prishtina. Ndeshja Penza - Bashkimi zhvillohet të hënë nga ora 19:00 dhe do të transmetohet në "ArtMotion" dhe "Kujtesa".

Rummenigge: Flick mund të qëndrojë në Bayern

MUNCHEN, 25 PRILL - Karl-Heinz Rummenigge ka lënë të kuptohet se Hansi Flick mund të qëndrojë në Bayern Munchen, me të gjitha palët e vendosura të ulen për një takim në

të ardhmen e afërt. "Ne kemi rënë dakord që do të ulemi pas ndeshjes në Mainz", ka thënë fillimisht drejtori i Bayernit për gazetën "BILD". "Nëse do ta plotësojmë

kërkesën e Hansit, të gjitha palët duhet të punojnë së bashku për të gjetur një zgjidhje me të cilën Bayerni është gjithashtu i kënaqur", ka shtuar Rummenigge.



Istogu regjistron fitoren e 22-të

ISTOG, 25 PRILL - Janë luajtur të shtunën katër ndeshje të xhiros së 22-të të Superligës së hendbollisteve. Është kjo xhiroja e fundit e pjesës së rregullt të garave. Istogu ka vazhduar ecurinë pozitive, duke shënuar

fitoren 22-të rresht. Istogaset fituan bindshëm ndaj Ferizajt me rezultat 42:19. Ndeshja e liderit me kampionin në fuqi u luajt në Ferizaj. Istogu në "play off" starton nga pozita e parë. Ka bilanc maksimal, 22 fitore e

44 pikë. Në "play off" do të luajë edhe Ferizaj, që nis nga pozita e katërt. Pra këto dy skuadra do të takohen edhe në gjysmëfinale të "play off"-it. Dukshëm më tepër rivalitet kishte në Vushtrri, ku u takuan Vushtrria dhe Prishtina.

Fitore me rezultat 27:26 shënoi skuadra prishtinase. Vushtrria në "play off" starton nga pozita e dytë, ndërsa Prishtina nga e treta. Edhe këto dy skuadra takohen mes vete. Jusuf Gërvalla fitoi ndaj Kastriotit në Ferizaj me



25:23, kurse Shqiponja e mposhti KEK-un me 27:22.

Shkëndija fiton titullin e kampiones

TETOVË, 25 PRILL - Shkëndija e Tetovës është zyrtarisht kampione e Maqedonisë së Veriut. Kuqezinjtë konfirmohen më të mirët në Maqedoni dhe ia dalin ta fitojnë titullin kampion për herë të katërt në histori. Skuadra e Ernest Gjokës mposhti 3-1 Borecit. Ekipi mik mbylli pjesën e parë në avantazh falë autogolit të Bejtulahit, ndërsa Shkëndija përmbysi gjithçka në pjesën e dytë. Mevlan Murati, Besart Ibraimi dhe Rubin Hebahj shënuan golat e fitores për Shkëndijen, që realizon objektivin e madh sezonal katër javë përpara fundit të kampionatit (+13 pikë). Vendi i dytë për Shkupin, që triumfoi 2-0 në kryeqytet kundër Rabotnickit falë golave të Cvetanoskit dhe Isenit. Struga Trim Lum arriti një fitore të madhe në fushën e Makedonija



GP, rival direkt për një post në Ligën e Evropës. Skuadra shqiptare fitoi 2-3 dhe ndodhet vetëm një pikë larg vendit të tretë. Vendasit po kryesonin 2-0 deri në minutën e 84-t, por Struga kreu një përmbysje të

çmendur dhe siguroi tri pikë fantastike. Humbje pësoi Renova, skuadra tjetër nga Tetova. Ekipi po garon për mbijetesën dhe sot doli pa pikë nga përballja jashtë fushe me Pelister, që fitoi minimalisht 1-0.

Lakersat pësojnë humbjen e tretë radhazi

Los Angeles, 25 prill - Rikthimi i Anthony Daviesit nuk i shërbeu aspak Los Angeles Lakersit që ta shmangë humbjen e tretë radhazi, pasi këtë herë kalifornianët u dorëzuan në transfertën ndaj Dallas Mavericksit, i cili u mposhtë me rezultat 108-93. Gjysma e parë e ndeshjes shkoi mjaft mirë për kalifornianët e Lakersit, që mori një avantazh prej 12-pikësh, por më pas gjysma e dytë u dominua totalisht nga vendasit e Dallasit, që përmbysën gjithçka dhe morën fitoren falë një performace mjaft të mirë të kanadezit Powell. Skuadra e Dallasit regjistron kështu suksesin e tretë radhazi dhe është gjithmonë e më pranë blindimit të pozitive në zonën "play-off" të renditjes në Konferencën e Perëndimit, ndërsa Los Angeles Lakersi vijon të jetë në rënie të lirë. Një nga sfidat më interesante të mbrëmjes ishte edhe ajo mes New Orleans Pelicansit dhe San Antonio Spursit, që përfundoi me suksesin e këtyre të fundit me shifrat 108-110. Të udhëhequr nga Demar DeRozan, miqtë e



Spursit patën një dominim të lehtë gjatë gjithë kohës, me përjashtim të fraksionit të tretë që foli plotësisht për vendasit. Me 39 pikë, 6 rikuperime dhe 2 asistime, Michael Porter u bë protagonist absolut i Denver Nuggetsit, që ia doli të fitojë bindshëm me shifrat 129-116 në "Ball Arena" ndaj Houston Rocketsit. Vendasit zgjidhën gjithçka që në gjysmën e parë të lojës, duke dominuar në fraksionin e parë dhe të dytë, ndërsa më pas u relaksuan disi, por avantazhi ishte komod dhe nuk vunë për asnjë moment në rrezik rezultatit, raporton "Supersport". Befason Minnesota

Timberwolves, që ia doli të triumfojë me rezultat 96-101 në transfertën e Salt Lake Cityt ndaj kryesuesve të Konferencës së Perëndimit, Utah Jazz. Këta të fundit e nisën në mënyrë të përkryer ndeshjen falë një forme mjaft të mirë edhe të serbit Bogdanoviç, por më pas ishin miqtë që morën kontrollin e lojës dhe përmbysën gjithçka, duke marrë një fitore që gjithsesi nuk i shërben shumë, pasi zona "play-off" është shumë larg. Në sfidat e tjera, Indiana Pacersi triumfoi me rezultat 115-109 ndaj Detroit Pistonsit, ndërsa Miami Heat fitoi me rezultat 106-101 ndaj Chicago Bullsit.

SHKURT

Presidenti i UEFA-s paralajmëron dënimin për klubet e Superligës

Presidenti i UEFA-s, Aleksandër Çeferin, po e mendon dënimin për ekipet e Superligës Evropiane. Barcelona, Real Madridi dhe Juventusit janë ende pjesë e saj. Të tre gjigantët evropianë nuk janë tërhequr zyrtarisht nga gara që u lansua saktësisht një javë më parë, duke krijuar një tërmet në botën e futbollit. "Të gjithë duhet ta marrin dënimin për atë që bënë dhe ne nuk mund të themi se asgjë nuk ka ndodhur. Ju nuk mund të bëni diçka të tillë dhe thjesht të thoni: Unë jam ndëshkuar sepse të gjithë më urrejnë", ka thënë Çeferin. "Por për mua është një ndryshim i qartë midis klubeve angleze dhe gjashtë të tjerëve. Ata u tërhoqën, ata pranuan se kishin bërë një gabim. Është madhështore të thuash kam gabuar", ka shtuar Çeferin.

Ende nuk dihet e ardhmja e Dembeles

E ardhmja e Ousmane Dembele te Barcelona mbetet në dyshim edhe pse në fund të sezonit mund të mos largohet. Mediat katalanase zbuluan një lajm të bujshëm në lidhje me Dembeles, ku thuhet se francezi nuk dëshiron ta rinovojë me Barcelonën dhe ka në plan të largohet në fundin e sezonit të ardhshëm me parametra zero. Por te Barcelona e përgënjeshtrojnë këtë lajm. Sipas "Mundo Deportivo", drejtuesit kanë mohuar kategorikisht këto lajme dhe janë shprehur se Dembele është listë e lojtarëve të pashtishëm. I njëjti burim ka mohuar të kenë vendosur çmimin 60 milionë euro për Dembeles. E gjithë vëmendja e klubit është të rinovimi me sulmuesin, kontrata e të cilit përfundon më 30 qershor 2022.

Nëse Ronaldo rikthehet në United, Pogba shkon te Juve

Paul Pogba është një emër që qarkullon në Torino në çdo sesion të merkatos, një diskutim që nuk ka ndryshuar që nga dita kur ai u largua nga Juventusit. Tifozët e "Zonjës së Vjetër" shpresojnë që francezi ta vesh sërish fanellën bardhezi, një operacion i vështirë në këtë kohë krizë, por mund të bëhet realitet vetëm nëse Cristiano Ronaldo rikthehet në "Old Trafford". Sipas "La Gazzetta dello Sport", ylli portugez po shqyrton mundësinë për t'u transferuar te Manchester Unitedi në fund të sezonit. Nëse kjo tratativë nis të marrë formë atëherë palët, Juventusit dhe Manchester Unitedi, mund të përfshijnë në negociatë edhe Pogban në mënyrë që ekipet t'i ulin kostot e këtij operacioni. Kujtojmë që të dy lojtarët janë nën kontratë me ekipet respektive deri në vitin 2022.

Klopp: Nuk e meritojmë të kualifikohemi në Ligën e Kampionëve

Liverpool - Newcastle përfundoi barazim. Edhe pse kaluan në avantazh që në minutën e tretë falë golit të Salahit, djemtë e Jurgen Kloppit e pësuan në minutat shtesë, duke lënë dy pikë për garën e Ligës së Kampionëve. Trajneri i "The Reds" nuk fshihet në prononcimin e dhënë për mediat, aty ku kritikon ashpër skuadrën e tij, që këtë sezon po has vështirësi të shumta në Premierë Ligë (renditet në vend të gjashtë). "Kur e meritojmë, e meritojmë. Unë mendoj se nuk e meritojmë të luajmë në Ligën e Kampionëve sezonin e ardhshëm. Kemi edhe pesë ndeshje për të luajtur, të shohim se çfarë do të jemi në gjendje të bëjmë. Ndeshjen e sotme e cilësojmë humbje. Nuk mund të krijojmë kaq shumë raste për gol dhe të mos e mbyllim ndeshjen. Shënuam një gol të shkëlqyer, por nuk e mbyllim dot ndeshjen. Nuk bëjmë aq mirë sa duhej. Dueli me Unitedin? Do të jetë një sfidë e vështirë. Është e thjeshtë: ose duhet të nxjerrim mësim nga këto gabime që po bëjmë ose duhet ta harrojmë kualifikimin në Ligën e Kampionëve për sezonin e ardhshëm", ka deklaruar Klopp.

Zidane: Asgjë nuk ka mbaruar në La Liga

Real Madridi luajti baras 0-0 në shtëpi kundër Real Betisit, duke humbur shumë terren në garën për titullin kampion. Trajneri Zinedine Zidane ka thënë se nuk është aspak i shqetësuar për këtë rezultat dhe kërkon përqendrim në sfidën e së martës

kundër Chelseat në Ligën e Kampionëve. "Ne lamë dy pikë dhe kjo është më se e qartë. Ishim shumë të mirë në fazën mbrojtëse, por vuajtëm në sulm. Na mungonte diçka, nuk shkëlqyem përpara portës kundërshtarë. Humbëm dy pikë dhe

tashmë ne jemi të dobët. Baraziam, por jemi të përqendruar në duelin e së martës. Kemi ende një rrugë të gjatë për të bërë në kampionat dhe do të luftojmë deri në fund. Asgjë nuk ka mbaruar sot. Jam i bindur se jemi gati për ndeshjen tjetër, e cila do të jetë më

e vështira e sezonit. Është e vërtetë që kundër Betisit na mungoi diçka, por jemi mirë. Rikthimi i Hazardit? Ai ishte me të vërtetë mbresëlënës. Jemi të lumtur që e shikojmë Edenin sërish në fushë sepse ai është një lojtar shumë i rëndësishëm për ne", ka thënë Zidane.



Hysen Beqa lindi në Molliq të Gjakovës. Ka mbaruar studimet për shkencë politike dhe administratë publike në Universitetin e Prishtinës. Beqa është autor i romanit "Misiri i vogël", i cili nga gjuha shqipe është përkthyer në gjuhën angleze, franceze, gjermane, italiane dhe polake. Ky është libri i tij i dytë.

Ky libër, në rrafshin tematik, është vazhdim i romanit *Misiri i vogël*, i po të njëjtit autor, botuar tri vjet më parë, në të cilin autori përsiat për veten, për shoqërinë, për botën që e rrethon.

Këtë libër herë e lexojmë si fikcion, herë tjetër si jetëshkrim. Brenda tekstit gjejmë shenja të autorit, por edhe të narrators. Ato që i rrëfen narratori janë ide të autorit, janë përkëpamje të tij për individët dhe shoqërinë. Heroi i romanit gjendet para shumë dilemave të mëdha të cilat ia krijon shoqëria.

Në këtë libër autori trajton fatin e shkrimtarit dhe ballafaqimin e tij me shoqërinë. Përmes ndodhjeve personale, del sheshit fati i shkrimtarëve në shoqërinë e Kosovës. Nëse dikur shkrimtari ishte prijës popullor, sot ai është shtresë e harruar nga shoqëria madje, nëpërmjet gojës së narrators homodiegetik, shkrimtarët konsiderohen të çmendur dhe janë ose bëhen objekt talljeje. Por, nëpërmjet stoicizmit të narrators Beqa mëton të tregojë se shkrimtaria nuk është thjesht një profesion a pasion, por mision.

Në këtë libër do të lexoni për politikën dhe për politikanët. Nuk do ta hasni autorin duke bërë politikë. Edhe pse nuk përmend emra të politikanëve dhe të politikave të këqija, është mjaft konkret, sepse përmend specifika të tyre. Këto raste të trajtuara për lexuesin semantik janë thjesht ide personale, kurse për lexuesin semiotik më tepër se kaq.

Albin Mehmeti


5.99€



SHKRIMTARI

HYSEN BEQA

HYSEN BEQA



Kaltrina Pacolli
Prishtinë

Zërin ngrite deri te Zoti.

Jetën mos ia fal askujt, përpos vetes.

Ti vlen sa gjithë bota, dhe bota pa ty është e mjerë.

Ti që botës i dhuron jetë, askush nuk ka të drejtë ta marrë atë nga ti.

Bërtit! Fol! Thuaje!


Unë jam gruaja më e fortë në botë!



6.99€



UNË, KUFOMA E ARDHSHME



Kaltrina Pacolli

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "ADER"-SH.P.K, me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me Numër Unik: 811389825, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "ADER" D.O.O, iz Gjakovice, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom JMB: 811389825 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that "ADER", L.L.C, in Gjakova, has taken the decision to quit its business with UIN: 811389825, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

"Epoka e re"

Prishtinë, 26.04.2021

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "IdeA-Communication"-SH.P.K, me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me Numër Unik: 810236910, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "IdeA-Communication" D.O.O, iz Gjakovice, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom JMB: 810236910 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that "IdeA-Communication", L.L.C, in Gjakova, has taken the decision to quit its business with UIN: 810236910, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

"Epoka e re"

Prishtinë, 26.04.2021

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ "Albanika" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 80657471. Delvina Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren.
- ▶ Serdar Spahi shpall të pavlefshme dëftesat certifikatën diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ "R Architects " ShPK shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit 71214273 Prizren.
- ▶ Besnik Hashani shpall të pavlefshme katër dëftesat, certifikatën si dhe diplomën e shkollës së mesme "Koxhë Kadri Prishtina" Prishtinë.
- ▶ N.N Besi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 71067157
- ▶ Gëzim Jashari shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Andon z . Çajupi"
- ▶ Kujtim Zeneli shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesën e SHMLM " Dr Xheladin Deda".
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

